


ANALIZË

SI MUND TË MARRË PËRSIPËR PUNËT NË
FUSHËN E TË RINJVE MINISTRIA E
POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE
RINISË



ANALIZË
SI MUND TË MARRË PËRSIPËR PUNËT
NË FUSHËN E TË RINJVE MINISTRIA
E POLITIKËS SOCIALE,
DEMOGRAFISË DHE RINISË

Konstantin Bitrakov
shtator 2024

IMPRESSUM

Projekti:

Praktiko demokraci

Titulli i originalit:

АНАЛИЗА НА КОЈ НАЧИН МИНИСТЕРСТВОТО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ ДА ГИ ПРЕЗЕМЕ РАБОТИТЕ ОД ОБЛАСТА НА МЛАДИТЕ - ANALIZË SI MUND TË MARRË PËRSIPËR PUNËT NË FUSHËN E TË RINJVE MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE RINIS

Botues:

Fondacioni Westminster për Demokraci, Republika e Maqedonisë së Veriut

Rreth botuesit:

Petar Trajkov, ushtrues i detyrës Drejtor në vend për Fondacionin Westminster për Demokraci

Autor:

Konstantin Bitrakov

Redaktore:

Stefani Spirovska

Lektorimi:

Kongresen Servisen Centar

E përkthyer nga maqedonisht në shqip:

Vjosa Taipi

Përpunimi teknik:

Petar Antevski

Shtypshkronja:

Pro Point

Tirazh:

50

Vendi i botimit:

Shkup

Viti i botimit:

2024


Kjo analizë u përgatit në kuadër të projektit “Praktiko demokraci” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet të Qeverisë Britanike.

PËRMBAJTJA

Hyrje	6
I. Historiku dhe perspektiva historike	7
II. Kuadri ligjor	10
1. Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore	10
2. Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligji për nëpunësit administrativë	14
3. Urdhëresë për parimet e organizimit të brendshëm të organeve të administratës shtetërore	16
4. Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore	16
5. Strategjia nacionale për të rinjtë	19
III. Prioritetet e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për të filluar punën në fushën e rinisë	20
1. Përshtatja e akteve në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe marrja në dorëzim e punonjësve të Agjencisë për Rini dhe Sport	21
1.1. Përshtatja e aktit për organizim të brendshëm	21
1.2. Përshtatja e aktit për sistematizimin e vendeve të punës	22
1.3. Marrja në dorëzim e punonjësve nga Agjencia për Rini dhe Sport	24
1.4. Plotësimi i vendeve të punës të sistematizuara vakante në njësitë pranë Sektorit për të Rinj	24
2. Ndryshimet në Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore në dispozitat ku parashikohet kompetenca e Agjencisë për Rini dhe Sport	25
3. Përgatitja e programit (të brendshëm) të punës e Sektorit për të Rinj në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë	25
Shënime pëfundimtar	25
Shtojca 1: Plani i veprimit i hapave prioritare	26
Shtojca 2: Propozimi për atë se si mund të duken ndryshimet në lighin për pjesëarrje rinore dhe politika rinore për marrjen e kompetencave	28

HYRJE

Në qershor të vitit 2024, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi ndryshimet në Ligjin për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore (LOFOASH).¹ Me këto ndryshime dhe plotësime në LOFOASH janë bërë ndryshime të rëndësishme në fushën e rinisë.² Konkretnisht, Agjencia për Rini dhe Sport u shfuqizua dhe kompetencat e saj në fushën e rinisë u bënë kompetencë e Ministrisë së transformuar të Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, e cila nga ana e saj shfaqet si pasardhëse ligjore e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Përveç kësaj, dispozitat ligjore përcaktojnë që Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të marrë përsipër edhe punonjësit që kryejnë punën në lidhje me rininë nga Agjencia (tani e shfuqizuar) për Rini dhe Sport, si dhe pajisjet përkatëse, inventarin dhe sende të tjera, arkivin, dokumentacionin, mjetet e punës, detyrimet dhe shlyerjen e detyrimeve, si dhe fonde të tjera nga Agjencia për Rini dhe Sport në lidhje me rininë.³



Pra, vullneti i ligjvënësit gjatë miratimit të ndryshimeve të përmendura në ndryshimin dhe plotësimin e LOFOASH ishte që punët në fushën e rinisë të mos kryhen nga një organ i pavarur i administratës shtetërore,⁴ por nga një ministri. Kështu, ligjvënësi vendosi që ishte më e përshtatshme që ministria që merrej me çështje të politikave sociale të bënte punën në fushën e rinisë, e cila në të njëjtën kohë ishte e privuar nga kompetenca për t'u marrë me çështje në fushën e punës, dhe iu dha kompetenca për t'u marrë me demografinë. Ligjvënësi gjithashtu i kushtoi vëmendje vazhdimësisë së stafit që merret me këto çështje, duke

¹ Këto ndryshime dhe plotësime të fundit në Ligjin për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore u propozuan më 6 qershor 2024 dhe u votuan nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 8 qershor 2024. Më shumë informacion është në dispozicion në: <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nsp?param=2b7c14cb-5383-451a-8fb8-ddaa86dfe1eb> (qasur më 24 shtator 2024). Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore të vitit 2024 është botuar në Gazetën Zyrtare nr. 121/2024.

² Sigurisht, u prezantuan edhe risi të tjera. Në fakt, ndryshimet dhe plotësimet në LOFOASH nga viti 2024 ishin më të mëdha. U reformua mënyra se si është organizuar administrata shtetërore (numri i ministrive u rrit nga 16 në 20, dhe një pjesë e resorëve dhe kompetencave të ministrive ekzistuese u ndryshuan gjithashtu), u parashikua që në të ardhmen një organ i administratës shtetërore, përveç një ministrie, të mund të themelohej me një ligj të veçantë vetëm pas një vlerësimi paraprak të ndikimit të rregullores, u parashikua një detyrim për drejtorët e organeve të pavarura të administratës shtetërore dhe organeve brenda ministrive për të paraqitur plane vjetore dhe raporte gjashtëmujore për punën në Qeveri, përkatësisht ministrinë resoriale, etj.

³ Shih: neni 28, paragrafi 1, pika 8 dhe neni 29, paragrafi 11, 13, 14 dhe 15 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore të vitit 2024 (Gazeta Zyrtare nr. 121/2024).

⁴ Agjencia për Rini dhe Sport kishte statusin e organit të pavarur të administratës shtetërore. Siç sugjeron emri i tyre, këto organe të administratës shtetërore nuk i përgjigjen asnjë ministrie të resorit, por drejtpërsëdrejti Qeverisë, e cila, në fakt, emëron dhe shkarkon drejtorët e tyre. Për dallim nga ministrat, është e qartë se drejtorët nuk janë anëtarë të Qeverisë dhe nuk marrin pjesë në punën e saj (përveç si përjashtim, kur mund të thirren për të marrë pjesë në seanca në kushte të veçanta, pa të drejtë vote).

parashikuar që punonjësit e Agjencisë për Rini dhe Sport, të cilët merreshin posaçërisht me çështjet e rinisë (dhe jo me çështje në fushën e sportit), do të kalonin në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale + **demografi dhe të rinj**

Mund të interpretohet, duke marrë parasysh këtë reformë, se për ligjvënësin (dhe për Qeverinë që u zgjodh menjëherë pas miratimit të ndryshimeve në LOFOASH) resori i të rinjve bëhet prioritet.

Megjithatë, miratimi i ndryshimeve në LOFOASH është vetëm një hap inicial. Në mënyrë që Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë të ndërmarrë me sukses zbatimin e kompetencave që lidhen me rininë (përkatësisht të vërehet një ndryshim pozitiv në ndërtimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me rininë dhe të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje), duhet të ndërmerren hapa të rëndësishëm shtesë: të përgatitet një analizë funksionale në të cilën, ndër të tjera, të përcaktohet se si duhet të riorganizohet ministria për të kryer me sukses kompetencat e reja të caktuara; të krijohen njësi të reja organizative; të sistemohen vendet e punës që do të plotësohen, në një pjesë, me punonjësit e Agjencisë për Rini dhe Sport; të përcaktohen prioritetet strategjike në portofolin e të rinjve; të përcaktohet një plan afatgjatë për punën e njësive përkatëse organizative dhe më shumë. Që këto hapa (disa prej të cilave tashmë kanë filluar) të ndërmerren me sukses, është e nevojshme të studiohen paraprakisht ligjet përkatëse, por edhe praktikat dhe përvoja aktuale në punën e Agjencisë për Rini dhe Sport. Në këtë drejtim po përgatitet edhe kjo analizë. Gjegjësisht, qëllimi është t'i shërbejë Ministrisë në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm në mënyrë që të fillojë të punojë në sektorin e rinisë. Kjo analizë u përgatit me mbështetjen e Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD).

I. HISTORIKU DHE PERSPEKTIVA HISTORIKE

Siç u përmend në fjalën e hapjes, në periudhën nga (korrik) 2000 deri në (qershor) 2024, Agjencia për Rini dhe Sport, e cila kishte statusin e një organi të pavarur të administratës shtetërore me cilësinë e një personi juridik, drejtori i të cilit emërohej dhe shkarkohej nga Qeveria, ishte kompetente të merret me çështjet e të rinjve, përkatësisht të kryejë punët e të rinjve.

Konkretisht, Agjencia për Rini dhe Sport u krijua me miratimin e (versionit fillestar të) LOFOASH në vitin 2000. Më pas ligjvënësi parashikoi që Ministria e deriatëhershme e Rinisë dhe Sportit⁵ do të shndërrohej në Agjencinë për Rini dhe Sport. Përveç drejtorit, Agjencia kishte edhe një zëvendësdrejtör. Shumica e punonjësve të Agjencisë për Rini dhe Sport kishin statusin e nëpunësve civilë,⁶ dhe vetëm një pjesë e vogël ishin persona ndihmës-teknikë (roje, korrier, etj.). Me përjashtim të vendeve të punës së këshilltarëve shtetërorë, të⁷ gjitha vendet e punës të tjera u sistematizuan në një nga disa njësitë organizative:


⁵ Kjo ministri është themeluar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për organet e administratës (Gazeta Zyrtare nr. 63/1998). Ligji për organet e administratës (versioni i konsoliduar i të cilit mbulonte tekstin origjinal të vitit 1990 dhe ndryshimet e vitit 1994 dhe 1998) pushoi së qeni i vlefshëm me hyrjen në fuqi të ligjit ekzistues LOFOASH.

⁶ Marrëdhënia e punës së nëpunësve është rregulluar fillimisht me Ligjin për nëpunësit civilë (Gazeta Zyrtare nr. 59/2000 ... 132/2014), dhe sot rregullohet me Ligjin për nëpunësit administrativ (Gazeta Zyrtare nr. 27/2014 ... 99/2022). Sipas këtij ligji, nëpunësit administrativë ndahen në dy grupe: nëpunësit shtetërorë dhe nëpunësit publikë. Punonjësit e Agjencisë për Rini dhe Sport janë klasifikuar si nëpunës shtetërorë.

⁷ Sipas Aktit për Sistematizimin e Vendeve të Punës, Agjencia për Rini dhe Sport parashikonte dy vende pune të një Këshilltari Shtetëror, përkatësisht Këshilltar Shtetëror për Sport dhe Rini dhe Këshilltar Shtetëror për Investime Kapitale dhe Objekte Sportive. Nga këto dy vende pune, vetëm i pari u plotësua. Akti për sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë për Rini dhe Sport është në dispozicion në: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fapi.ams.gov.mk%2Fwp-content%2Fuploads%2F2021%2F11%2Fsistematizaczija-so-site-izmeni-15.06.2021-1.doc&wdOrig-in=BROWSELINK> (пристапено на 30.09.2024 година).

SEKTORI	NJËSIA
/	Njësia për Mbikëqyrje Inspektuese
/	Njësia për Revizion të Brendshëm ⁸
Sektori për Burime Njerëzore dhe Mbështetje të Punës së Drejtorit	Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Protokoll
	Njësia për Mbështetje të Drejtorit
Sektori për të Rinj	Njësia për Integrim Evropian dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar midis të Rinjve
	Njësia për Politika Rinore
Sektori për Sport	Sektori për Sport Kombëtar dhe Ndërkombëtar
	Njësia e Mbështetjes Ligjore në Sport
	Njësia për Integrim Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Sport
Sektori për Investime Kapitale dhe Objekte Sportive	Njësia për përgatitje projektuese dhe teknike dhe përcaktimin e dinamikës dhe shkallës së kryerjes së punimeve ndërtimore
	Njësia për Objekte Sportive
Sektori për Çështje Juridike dhe Financiare	Njësia për Kontroll Buxhetor, Koordinim, Kontabilitet dhe Pagesa
	Njësia për Prokurime Publike

ak para se të shfuqizohej, Agjencia për Rini dhe Sport kishte gjithsej 46 punonjës, përfshirë 11 në Sektorin për të Rinj.⁹ Në pajtim me sa më sipër, numri i të punësuarve në Sektorin për të Rinj arriti në pak më pak se 24% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Për më tepër, shumica e të punësuarve në Sektorin për të Rinjtë u shpërndanë në Njësinë për Integrim Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar me Rininë, që flet për kapacitetet e vogla të Njesisë për Politika Rinore.



⁸ Sektori për revizion të brendshëm ka qenë i paraparë, por nuk është plotësuar asnjë vend pune. Shih: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fapi.ams.gov.mk%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F09%2Ftabelaren-pregled-na-vraboteni-vo-ams-09.-2023.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK> (qasur më 30.09.2024).

⁹ Shiko: Paraqitje tabelare e të punësuarve të Agjencisë së Rinisë dhe Sportit, në dispozicion në: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fapi.ams.gov.mk%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F09%2Ftabelaren-pregled-na-vraboteni-vo-ams-09.-2023.xlsx&wdOrigin=BROWSELINK> (qasur më 30.09.2024). Nëse marrim parasysh edhe Këshilltarin Shtetëror për të rinj dhe sport si një punonjës që bën punë në fushën e rinisë, atëherë numri i përgjithshëm i punonjësve që merren me çështjet e rinisë do të ishte 12.

Prandaj, është evidente se fokusi në Agjencinë për Rini dhe Sport ishte më shumë në sport dhe çështje të lidhura (investime kapitale dhe lehtësira në fushën e sportit) sesa në çështjet e të rinjve. Për fat të keq, kjo situatë ka çuar në një vakum të caktuar, përkatësisht shpesh është vërejtur se është e nevojshme të ndahen më shumë burime, përfshirë burimet njerëzore, për të ndërtuar politika cilësore për të rinjtë, por edhe për të siguruar zbatimin e angazhimeve të përshkruara nga dokumentet strategjike.

Së fundi, në vitin 2024, siç është theksuar tashmë, duke manifestuar vullnetin e tij se punët në fushën e rinisë dhe sportit nuk duhet të kryhen nga një organ i pavarur i administratës shtetërore, por nga një ministri, ligjvënësi shfuqizoi Agjencinë për Rini dhe Sport. Përgjegjësitë e saj u transferuan në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe në Ministrinë e Sportit. Është e vështirë të supozohet se mbi çfarë është bazuar mendimi i ligjvënësit, duke qenë se në këtë drejtim nuk është deklaruar asgjë në shpjegimin e propozim - ligjit për ndryshimin e LOFOASH-së.¹⁰ Gjithsesi, mund të interpretohet se bëhet fjalë për dëshirën t'i kushtohet më shumë vëmendje çështjeve në fushën e rinisë.

Pra, historikisht, ka pasur dy vendime politike diametralisht të kundërta: së pari në vitin 2000, çështjet në fushën e rinisë u dorëzuan nga një ministri në një organ të pavarur të administratës shtetërore, që më pas në vitin 2024 ato t'i dorëzohen një organi të pavarur të administratës shtetërore përkatësisht një ministrie.



Vlen të theksohet se dispozitat e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LOFOASH,¹¹ me të cilat parashihej shfuqizimi i Agjencisë për Rini dhe Sport, nuk u dhanë me efekt të prolonguar. Kjo ka rezultuar në disa sfida për Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Nga njëra anë, u krijua presion për të marrë menjëherë përsipër punonjësit e Agjencisë për Rini dhe Sport, të cilët kryenin punë në fushën e rinisë.¹² Nga ana tjetër, kjo nuk mund të zbatohet menjëherë, duke qenë se as akti për organizimin e brendshëm dhe as akti për sistematizimin e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë nuk u përshtatën me dispozitat e reja të LOFOASH.¹³ Përveç kësaj, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë nuk fitoi një periudhë në të cilën mund të kryeshin aktivitete të tjera përgatitore, përveç transferimit të punonjësve, me qëllim ndërmarrjen përsipër të punëve në fushën e rinisë. Prandaj, për të lehtësuar procesin e ndërmarrjes së kompetencave dhe punonjësve, vazhdimi i kësaj analize do të shqyrtojë hapat e ardhshëm që duhet të ndërmarrë Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Megjithatë, para se të fillojë shqyrtimi i tyre, do të bëhet një rishikim i dispozitave më të rëndësishme të ligjeve përkatëse për të sqaruar bazën për hapat e planifikuar të ardhshëm.

¹⁰ Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e LOFOASH datë 06.06.2024 me nr. arkivor 08-2868/1 është në dispozicion në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut: <https://www.sobranie.mk/materijali-parlament.nsp> (qasur më 30.09.2024). Në shpjegimin e këtij propozim - ligji nuk përmendet aspak Agjencia për Rini dhe Sport. Më shumë vëmendje i kushtohet nevojës për riorganizimin e ministrive.

¹¹ Gazeta Zyrtare nr. 121/2024.

¹² Edhe pse afati për marrjen në dorëzim të punonjësve të Agjencisë për Rini dhe Sport është pesë muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve në LOFOASH. Duke qenë se ndryshimet dhe plotësimet LOFOASH në fuqi më 10.06.2024, afati i fundit për ndërmarrjen e punonjësve të Agjencisë për Rini dhe Sport (të cilët kryejnë punën në fushën e rinisë) është 10.11.2024. Shih: Neni 29, paragrafi 13 së bashku me nenin 29, paragrafi 11 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LOFOASH (Gazeta Zyrtare nr. 121/2024).

¹³ Me fjalë të tjera, nuk kishte as njësi organizative të përshtatshme dhe as punë të sistematizuara për të cilat mund të caktoheshin punonjësit e Agjencisë për Rini dhe Sport që merreshin me çështje në fushën e rinisë.

II. KUADRI LIGJOR

1. LIGJI PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Një pjesë e dispozitave të LOFOASh-së, tashmë janë përpunuar, përkatësisht, tashmë u është kushtuar vëmendje dispozitave që shfuqizuan Agjencinë për Rini dhe Sport dhe që parashikonin transferimin e (një pjese) të kompetencave, punonjësve dhe ngjashëm në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Megjithatë, me këtë rast, ne do t'i referohemi përsëri dispozitave të LOFOASh-së. Aludojmë në dispozitat në lidhje me kompetencat e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Analiza e këtyre dispozitave është e nevojshme për të kuptuar se çfarë duhet të bëjë Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në sektorin e rinisë.

Kështu, kompetencat e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë parashikohen në nenin 24, paragrafi 1 nga gjithsej 21 pikë. Sigurisht, vetëm një pjesë e këtyre kompetencave iu referohen të rinjve. Nëse përpiqemi të bëjmë filtrim, do të arrijmë në përfundimin se Ministria, në fushën e rinisë, duhet të ushtrojë kompetencat në lidhje me:

- mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve
- mbrojtjen e të rinjve dhe grave
- përgatitjen dhe zhvillimin e politikës rinore
- kujdesin për zhvillimin psikofizik të të rinjve dhe mbrojtjen e tyre
- inkurajimin dhe asistimin e formave të organizimit rinor
- ndërmarrjen e masave për krijimin e kushteve për të mbajtur të rinjtë e aftë dhe të talentuar në Republikë, si dhe krijimin e kushteve për stimulimin e kthimit të tyre
- nxitjen e punësimit të të rinjve.

Në dy pikat e fundit të nenit 24, paragrafi 1 përmban edhe dy norma referimi, sipas të cilave Ministria kryen edhe mbikëqyrjen brenda kompetencave të saj (të cilat, natyrisht, duhet të përcaktohen më tej në një ligj të veçantë), që do të thotë, kryen punët e tjera të përcaktuara me ligj (që do të thotë se ligjet e tjera, përveç LOFOASh, përcaktohen edhe kompetencat e Ministrisë).

Menjëherë vërehet se formulimet janë të përgjithshme, siç i përshtaten dispozitave të përfshira në një ligj sistemik. Gjithashtu, pjesa më e madhe e këtyre dispozitave janë të njëjtat që kanë rregulluar në të kaluarën juridiksionin e Agjencisë për Rini dhe Sport. Megjithatë, nga këto dispozita mund të nxirret një përfundim se cilat janë përparësitë e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në resorin me interes për ne (përkatësisht resorin e rinisë). Së pari, ekziston një konsensus që ministritë si organe të administratës shtetërore, në përgjithësi, kryejnë disa aktivitete.¹⁴ Së pari, zbatojnë politikën e vendosur nga Kuvendi dhe Qeveria, përkatësisht zbatojnë ligjet dhe aktet e tjera të përgjithshme. Ministritë e bëjnë këtë duke miratuar akte të përgjithshme ligjore (rregullore administrative) dhe akte të veçanta administrative (zakonisht të quajtura aktvendime). Gjithashtu, me qëllim zbatimin e politikës dhe ligjeve të përcaktuara, ministritë kryejnë veprime dhe masa të tjera (administrative) (mbajnë evidencë, mbajnë regjistra, ekzekutojnë vendime, etj.). Së dyti, ministritë monitorojnë situatën në resorët për të cilët janë krijuar dhe i japin iniciativa Qeverisë, ndërsa përmes saj edhe Kuvendit, me qëllim zgjidhjen e problemeve të hapura. Ky aktivitet i dytë i ministrive, dukshëm, ka dy komponentë: iniciativa analitike dhe kreative. Në ushtrimin e kompetencave të tyre, ministritë mbledhin një sasi të madhe të të dhënave të cilat më pas i analizojnë për të ofruar përfundimisht masa për përmirësimin e situatës. Së treti, ministritë përgatisin rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme dhe kryejnë punë profesionale për Qeverinë dhe Kuvendin. Së katërti, ministritë zgjidhin çështje

¹⁴ Më shumë në: Davitkovski B., Pavlovska-Daneva A. (2018). E drejta administrative – Pjesa e parë (e drejta materiale), Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, faqe 249-270. Publikimi është në dispozicion përmes : https://www.ukim.edu.mk/e-izdaniya/PRF/Administrativno_pravo_1.pdf (qasur më 30.09.2024).

administrative në përputhje me ligjin. Kjo nënkupton zbatimin e normave të përgjithshme në situata dhe marrëdhënie specifike, përkatësisht zgjidhjen e të drejtave, detyrimeve dhe interesave ligjore të personave fizikë dhe juridikë. Së fundi, e pesta, ministritë ushtrojnë mbikëqyrje administrative. Ekzistojnë disa lloje të mbikëqyrjes administrative, të tilla si mbikëqyrja e akteve të përgjithshme, mbikëqyrja e akteve specifike dhe mbikëqyrja e inspektimit. Nëse marrim parasysh këto aktivitete të përgjithshme të ministrive dhe i kryqëzojmë me shtatë pikat (nga neni 24, paragrafi 1) të LOFOASH, do të arrijmë në përfundimin se Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë duhet të punojë në fushën e rinisë, përkatësisht cilat janë përparësitë e saj. Këto prioritete, përkatësisht detyrat e Ministrisë janë paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

MINISTRIA KRYEN PUNËT QË KANË TË BËJNË ME:	ÇFARË DO TË THOTË NË PRAKTIKË:
Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve ¹⁵	Megjithëse në pamje të parë duket se këto dy kompetenca hyjnë në portofolin e “të rinjve”, vlen të përmendet se ato ishin parashikuar edhe para ndryshimeve në LOFOASH të vitit 2024, si kompetenca të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Këto kompetenca ishin nën resorin e “politikës sociale”. Prandaj, ato do të vazhdojnë të kryhen nga njësitë organizative përkatëse që i kanë ushtruar deri më tani. Prandaj, nuk do t'i kushtojmë vëmendje shtesë atyre në këtë analizë.
Mbrojtja e të rinjve dhe grave	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë është kompetente për të përgatitur akte që do të hartojnë politika në lidhje me rininë. Një veprim i tillë është, për shembull, Strategjia Kombëtare për Rininë, e cila parashikohet në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politika rinore, i cili do të diskutohet më tej. Pas përfundimit të strategjisë aktuale, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të jetë organi që do të duhet të vlerësojë atë që është përfunduar deri më tani ¹⁶ dhe të përshkruajë angazhime dhe masa të reja strategjike (të cilat më pas duhet të miratohen nga Qeveria). Sigurisht, kjo bëhet në koordinim me organet e tjera që, sipas kompetencave të tyre, duhet të përfshihen në krijimin e politikave rinore.
Përgatitja dhe zhvillimi i politikës rinore	Gjithashtu vlen të përmendet se krijimtaria e Ministrisë në këtë drejtim mund të jetë e gjerë dhe mund të miratohen akte të tjera strategjike, përveç strategjisë së përmendur. Ministria gjithashtu duhet të ketë përfaqësuesit e saj në trupat ndër-resorialisht të punës që diskutojnë politikën, gjegjësisht aktet që ndikojnë në politikën e të rinjve (për shembull, në trupat e punës për strategjinë e arsimit, strategjinë e punësimit, etj.).
	Pra, këtu shohim veprimtarinë e monitorimit të situatës dhe dhënies së nismave, përkatësisht veprimtarinë analitiko-kërkimore dhe krijuese të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

¹⁵ Vlen të theksohet se në një ndërhyrje të ardhshme në LOFOASH, ky paragraf mund të riformulohet në mënyrë që të tregohet vetëm “mbrojtja e fëmijëve”. E japim këtë sugjerim sepse termat “fëmijë” dhe termat “të mitur” janë në thelb sinonime. Neni 1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve thotë se një fëmijë është “çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç”. Personat nën moshën 18 vjeç në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të mitur.

¹⁶ Edhe pse, natyrisht, zbatimi i Strategjisë Kombëtare për të rinjtë duhet të monitorohet vazhdimisht dhe raportet duhet të lëshohen herë pas here duke shpjeguar se cilat masa janë zbatuar.

	Në kuadër të kësaj kompetence, gjithashtu, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë duhet të përgatisë projekt-rregullore të rëndësishme për të rinjtë çështjet e të rinjve. Konkretisht, kompetenca është përgatitja e politikave në fushën e rinisë ndërsa politikat shndërrohen në ligje. Këtu po flasim për një marrëdhënie të dyanshme: Ministria mund të iniciojë miratimin e ligjeve të reja ose ndryshimin e atyre ekzistuese në Qeveri, ose Qeveria mund ta detyrojë Ministrinë të përgatisë një projekt-rregullore. Sigurisht, Ministria, në bazë të një ligji, mund të ketë juridiksion dhe të miratojë akte nënligjore (rregulla, udhëzime, etj.). Pra, për të zbatuar këtë kompetencë të ministrisë, do të jetë e nevojshme të kryhet edhe veprimtaria e përgatitjes së ligjeve dhe rregulloreve të tjera.
Kujdesi për zhvillimin psikofizik të të rinjve dhe mbrojtjen e tyre	Shqetësimi për zhvillimin psikofizik të të rinjve dhe mbrojtjen e tyre duhet parë sërish nga prizmi i monitorimit të situatës dhe dhënies së iniciativave (Qeverisë dhe Kuvendit për përmirësimin e zhvillimit të të rinjve dhe mbrojtjen e tyre). Kjo për shkak se Ministria, si organ i administratës shtetërore, nuk mund t'u japë mbrojtje të drejtpërdrejtë të rinjve dhe/ose të monitorojë zhvillimin e tyre (i cili do të ishte i qenësishëm në një institucion publik). Pra, për të monitoruar zhvillimin psikofizik të të rinjve, përkatësisht për të hartuar politika për mbrojtjen e tyre, Ministria duhet të mbledhë të dhëna që flasin për këto kushte dhe fenomene dhe të propozojë zgjidhje të përshtatshme.
Inkurajimi dhe asistimi i formave të organizimit rinor	Për të inkurajuar dhe ndihmuar organizimin e të rinjve, Ministria mund dhe duhet të kryejë më shumë aktivitete. Së pari, Ministria duhet të ndërmarrë zbatimin e Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore,¹⁷ i cili do të diskutohet më tej në tekst. Së dyti, Ministria duhet të hartojë ose përgatisë një program/platformë për të ndihmuar format e organizatave rinore, zbatimin e të cilave do të përfshijë dhe zbatojë projekte dhe fushata që do të motivojnë organizatat rinore në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare që trajtojnë çështjet rinore brenda aktiviteteve të tyre, si dhe në bashkëpunim me shoqatat dhe fondacionet vendase, përkatësisht palët e interesuara në sektorin joqeveritar. Së treti, Ministria mund të shpallë thirrje publike për grante dhe lloje të tjera të mbështetjes financiare për organizatat rinore.¹⁸ Së katërti, do t'i kthehemi përsëri monitorimit të situatës dhe dhënies së iniciativave. Ministria duhet të monitorojë situatën me organizatën rinore, të gjejë pengesat për intensifikimin e organizatës rinore dhe t'i propozojë masa për rritjen e saj Qeverisë dhe, në instancë të fundit, Kuvendit. Kjo do të

¹⁷ Gazeta Zyrtare nr. 10/2020

¹⁸ Publikimi i thirrjeve publike për mbështetje financiare dhe grante nënkupton përfshirjen e disa njësive organizative brenda Ministrisë. Mbi të gjitha, këto do të ishin Sektori për të Rinjtë (për të cilin më shumë mund të shihet më poshtë) dhe Departamenti i Politikave të të Rinjve, i cili do të përshkruante skemat e granteve, objektivat e grantit dhe kushtet për aplikim. Praktiki, i gjithë vizioni pas një granti të caktuar do të vinte nga ky Sektor. Por në kontekst më të gjerë, do të përfshihen njësitë e tjera organizative: Sektori për Çështje Financiare, i cili do të përcaktojë nëse dhe sa fonde janë në dispozicion, Sektori për Çështje Ligjore, të Përgjithshme dhe Rregullatore, i cili duhet të marrë parasysh aspektet ligjore të grantit (pajtuueshmëria me rregulloren), dhe Sektori për Programet dhe Fondet e BE-së, përkatësisht Sektori për Integrim Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, nëse në një rast specifik është një rialokim – ndarja e fondeve që rrjedhin nga një projekt tjetër ku vetë Ministria ka marrë një grant rialokimi.

	nënkuptonte miratimin, nëse konsiderohet e nevojshme, të ligjeve të reja dhe/ose ndryshimeve të ligjeve ekzistuese. Sigurisht, duke pasur parasysh faktin se kjo kompetencë tashmë është ushtruar nga Agjencia për Rini dhe Sport në të kaluarën (punonjësit e së cilës do të merren nga Ministria), ka përvojë të mjaftueshme të mëparshme për ekzekutimin e saj të suksesshëm dhe efektiv.
Marrja e masave për krijimin e kushteve për të mbajtur të rinjtë e aftë dhe të talentuar në Republikë, si dhe krijimin e kushteve për stimulimin e kthimit të tyre	Ngjashëm si në kompetencën e mëparshme, këtu mund të ndërmerren aktivitete të ndryshme, të cilat, më së shpeshti në mënyrë indirekte, do të ndikojnë në mbajtjen e të rinjve të aftë dhe të talentuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, duke qenë se i ashtuquajtimi largim i trurit ndodh për shkak të një numri faktorësh,¹⁹ është e nevojshme të krijohet një bashkëpunim intensiv me ministritë e tjera, portofolet e të cilave lidhen me mbajtjen e të rinjve të aftë dhe të talentuar në vend. Këtu i referohemi kryesisht Ministrisë së arsimit dhe shkencës dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës. Gjithashtu, në një kontekst më të gjerë, bashkëpunimi me Ministrinë e transportit është jashtëzakonisht i rëndësishëm, në mënyrë që të punohet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore të nevojshme për të rinjtë, por edhe për Ministrinë e vetëqeverisjes lokale dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për të rinjtë brenda komunave. Përveç kësaj, është e nevojshme të përfshihen vetë të rinjtë në ndërmarrjen e këtyre aktiviteteve (për mbajtjen e të rinjve në vend), në mënyrë që aktivitetet të ndërtohen nga të rinjtë për të rinjtë. Ideja është të demonstron se në një sistem të mirëorganizuar, ku të rinjtë do të kenë mundësi për arsimim dhe punësim adekuat, infrastrukturë adekuate dhe potencial për t'u përfshirë në politikëbërje (në nivel kombëtar dhe lokal), ata do të jenë më të motivuar për të qëndruar në vend. E thënë thjesht, përmes aktiviteteve intensive në bashkëpunim me portofolet e tjera, Ministria duhet të punojë për të shkëputur të rinjtë nga mendimi për t'u larguar nga vendi. Pra, duke marrë parasysh përparësitë e të rinjve (arsimim më i mirë, mundësi për punësim të përshtatshëm, cilësi më të lartë të jetës), Ministria duhet të koordinojë bashkëpunimin ndërministror për të zgjidhur problemet e të rinjve.
Nxitja e punësimit të të rinjve	Në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, dhe mbi të gjitha me Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës dhe Agjencinë për Punësim, është e nevojshme të përshkruhen aktivitetet që synojnë nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve (që do të nënkuptonte dhënien e ideve të reja krijuese se si të mundësohet valorizimi i njohurive dhe aftësive të të rinjve në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, mjeteve digjitale, etj.). Në këtë mendim, mund të rishikohen aktivitetet e zbatuara tashmë,²⁰ të vlerësohet suksesi i tyre dhe të parashikohen aktivitete të reja.

¹⁹ Më shumë për ikjen e trurit dhe faktorët që ndikojnë në të në punim: Young, J. (2024) Brain Drain: Definition, Causes, Effects and Examples, Investopedia, достапен на: https://www.investopedia.com/terms/b/brain_drain.asp#:~:text=Causes%20of%20Brain%20Drain&text=Some%20of%20the%20main%20reasons,on%20religion%2C%20gender%2C%20or%20sexuality (qasur më 30.09.2024).

²⁰ Për shembull, grantet për vetëpunësim të Agjencisë për Punësim.

Gjithashtu, në strategjitë dhe dokumentet e tjera të ngjashme, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë duhet t'i kushtojë vëmendje punësimit të të rinjve. Kur themi se vëmendja duhet t'u kushtohet të rinjve, është e rëndësishme të theksohet se, ndër të tjera, kjo nënkupton zhvillimin dhe/ose forcimin e të ashtuquajturave aftësi të buta midis të rinjve, dhe veçanërisht aftësitë e sipërmarrjes (vendosja e qëllimeve, komunikimi, udhëheqja, menaxhimi i projekteve, investimi, krijimi i bizneseve fillestare, etj.).

Për ta përmbledhur, dispozitat e LOFOASh, Demografisë dhe Rinisë (në fushën e rinisë) janë të përgjithshme, e cila është e natyrshme në dispozitat e përfshira në një ligj sistemik që hedh themelet për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore. Megjithatë, nëse marrim parasysh aktivitetet e administratës, si dhe të ministrive, mund të arrijmë në disa njohuri se çfarë aktivitetesh priten nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për të përmbushur kompetencat e përgjithshme të LOFOASh. Përveç kësaj, këto kompetenca mund të operacionalizohen më tej në ligje të tjera, ashtu si mund të parashikohen kompetenca shtesë në ligje të tjera.

2. LIGJI PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN PUBLIK DHE LIGJI PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIVË

Ligji për të punësuarit në sektorin publik²¹ është me rëndësi për Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë sepse përmban dispozita për aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në të gjitha institucionet e sektorit publik. Në këtë kontekst, këto dispozita do të zbatohen gjatë krijimit të njësive të reja organizative në Ministri që do të jenë kompetente për të punuar në çështjet e të rinjve, pra gjatë sistematizimit të vendeve të punës për nëpunësit civilë që do të merren me çështjet e të rinjve.

Më të rëndësishmet në këtë drejtim janë dispozitat e nenit 17 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik.

Aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës

Neni 17

- (1) Akti i organizimit të brendshëm për çdo institucion të sektorit publik përcakton llojin dhe numrin e njësive organizative dhe fushën e punës së tyre, ku përfaqësimi grafik i organizimit të institucionit (organogrami) është pjesë përbërëse.
- (2) Akti për sistematizimin e vendeve të punës, për çdo vend pune në institucionin e sektorit publik, përcakton grupin, nëngrupin, kategorinë dhe nivelin ku përket vendi i punës, si dhe kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës për çdo vend pune.
- (3) Institucionet përgatisin dhe miratojnë aktin për organizimin e brendshëm dhe aktin për sistematizimin e vendeve të punës, që mbulon njësitë organizative dhe vendet e punës të të gjithë punonjësve, në përputhje me grupet e vendeve të punës të përcaktuara në këtë ligj.

²¹ Gazeta Zyrtare nr. 27/2014, 199/2014; 27/2016; 35/2018; 198/2018; 143/2019; 14/2020; 302/2020.

(4) Institucionet miratojnë aktet e përmendura në paragrafin (3) të këtij neni pas kryerjes së një analize funksionale të bazuar në prova. Në institucionin ku, për shkak të procesit të integritetit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, përkatësisht për shkak të angazhimeve të ndërmarra nga projektet e BE-së, ekziston nevoja për sistematizimin e më shumë vendeve të punës sesa përcaktohet në paragrafin (5) të këtij neni, numri i vendeve të punës të sistematizuara përcaktohet në përputhje me analizën funksionale të miratuar nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë dhe organi përgjegjës për buxhetin.

(5) Akti për sistematizimin e vendeve të punës mund të sistematizojë deri në 10% më shumë vende pune se për vendet e punës për të cilat sigurohen burime financiare për paga dhe shtesa në buxhetin e institucionit, me përjashtim të institucioneve me më pak se 30 punonjës, në të cilat mund të sistematizohen deri në 50 vende pune, nëse ka rritje të kompetencave të institucioneve në përputhje me ligjin kur numri i vendeve të punës përcaktohet në përputhje me analizën funksionale.

(6) Në aktet e sistematizimit, postet e nëpunësve të autorizuar në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe inteligjencës, të këshilltarëve të posaçëm dhe të nëpunësve të kabinetit, mund të shënohen si të veçanta dhe ato nuk regjistrohen në Katalog.

(7) Akti për organizimin e brendshëm dhe akti për sistematizimin e vendeve të punës miratohen nga udhëheqësi i institucionit me pëlqimin paraprak të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë në lidhje me pajtueshmërinë e tyre të ndërsjellë, si dhe pajtueshmërinë e tyre me dispozitat e këtij ligji, si dhe nga organi kompetent për dhënien e pëlqimit për aktin e përcaktuar me ligj ose rregullore tjetër në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ato ligje ose rregullore.

(8) Pavarësisht nga paragrafi (7) i këtij neni, Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Brendshme dhe organi brenda Ministrisë së Brendshme - Byroja e Sigurisë Publike, Agjencia e Sigurisë Kombëtare, Agjencia e Inteligjencës, organi brenda Ministrisë së Financave - Drejtoria e Policisë Financiare për nëpunësit e autorizuar, gjykatat dhe prokuroritë publike përcaktojnë organizimin e brendshëm, përkatësisht formimin, si dhe sistematizimin e vendeve të punës në përputhje me ligje të veçanta ose rregullore të tjera, dhe pa pëlqimin paraprak të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

(9) Përmbajtja dhe mënyra e përgatitjes së akteve të përmendura në paragrafin (3) të këtij neni, si dhe përmbajtja e analizës funksionale të përmendur në paragrafin (4) të këtij neni, përcaktohen nga Ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

Siç mund të shihet nga pika 9 e nenit të cituar, përveç vetë Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, akti nënligjor që rregullon përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së rregulloreve,²² pra analiza funksionale, është gjithashtu e rëndësishme. Bëhet fjalë për Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së akteve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe përmbajtjen e analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik.²³ Është gjithashtu e dobishme të merret parasysh Metodologjia për kryerjen e analizës funksionale në institucionet e sektorit publik e cila u zhvillua nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratë, e cila shpjegon²⁴ në detaje se si duhet të duket procesi i përgatitjes së analizës funksionale. Ne nuk do të shtjellojmë më tej këto akte me këtë rast, duke marrë parasysh se Ministria për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini tashmë ka filluar procesin e përgatitjes së një analize funksionale që do të marrë parasysh lajmet e ndryshimeve në Ligjin për prokurimin publik nga 2024. Siç u theksua në vërejtjet hyrëse, qëllimi i kësaj analize është të shërbejë si një burim shtesë në procesin

²² Këto janë dy rregulla individuale, respektivisht rregullat për organizimin e brendshëm dhe rregullat për sistematizimin e vendeve të punës.

²³ Gazeta Zyrtare nr. 11/2015, 217/2021, 159/2022, 254/2023.

²⁴ Kompetencat e të cilëve në aspektin e administratës publike kanë kaluar në Ministrinë e sapokrijuar të Administratës Publike, në përputhje me ndryshimet në LOFOASH të vitit 2024.

e përgatitjes së një analize funksionale që do të mbulojë të gjithë Ministrinë për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini (duke pasur parasysh faktin se kjo analizë është më e ngushtë, d.m.th. i referohet vetëm çështjeve në fushën e rinisë).

Ndërkohë, Ligji për nëpunësit administrativë²⁵ është i rëndësishëm për ministrinë, duke pasur parasysh se punonjësit që do të merren nga Agjencia për Rini dhe Sport kanë statusin e nëpunësve civilë. Prandaj, në procesin e përshtatjes së rregullores për sistematizim për të marrë përsipër punonjësit nga Agjencia për Rini dhe Sport, është e nevojshme të kihet kujdes që përshkrimi i detyrave, kualifikimet e nevojshme, etj, të korrespondojnë me dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativë.

3. URDHËRESË PËR PARIMET E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

